



## Editorial

# Një KOMUNITET SHËRUES NË SPITAL

**Fratel Ruggero Valentini**  
President,

Fondacioni "Zoja e Këshillit të Mirë", Tiranë



Sistemi shëndetësor ka kudo probleme. Jo vetëm në SHBA ku nuk ka një karakter universal që u siguron të gjithë qytetarëve akses në shërbimet shëndetësore dhe të konsiderohet një instrument themelor për promovimin e barazisë dhe garantimin e të drejtës për shëndetësi, por shfaq gjithashtu vështirësi edhe në Britaninë e Madhe apo Itali, ku është i strukturuar prej dekadash. Krizat ekonomike, pandemitë, pabarazitë sociale, ndryshimet klimatike dhe konfliktet po shkaktojnë një tërmet në shëndetësi. Ndërsa shtetet shkurtojnë fondet qytetarët heqin dorë nga trajtimet shëndetësore. "Turizmi shëndetësor" vazhdon të rritet,



në kërkim të terapive më pak të kushtueshme ndërkohë që këto "udhëtime plot shpresë" ushqejnë iluzione dhe zhgënjime në shumë familje. Kjo panoramë ka efekte shkatërruese në shoqëri. "Tregu" ndërkohë jo gjithmonë krijon hapësira për qëllime fisnike siç duam të gjithë kur bëhet fjalë për shëndetin. Privatizimi i mjekësisë është i ngutshëm duke lënë pas ata që gjenden në vështirësi. Edhe vetë punonjësit shëndetësorë (mjekët, infermierët, etj.) rrezikojnë të hyjnë në një koncept merkantilizist të mjekësisë.

Kjo panoramë na provokon. **Fondacioni Zoja e Këshillit të Mirë ka tridhjetë vjet që ofron kujdes shëndetësor**

**në Shqipëri.** Natyra e tij si një organizatë jofitimprurëse ku çdo e ardhur duhet të ndahet ekskluzivisht për zhvillimin e qëllimeve të përcaktuara në Statut si dhe **ideali nga i cili u krijua, pra duke u mbështetur në karizmën e krishterë të të lumit Luigji Monti** janë gurët e themelit që mbështesin veprimtarinë e tij. Gjithashtu na shoqëron edhe energjia shpirtërore e Shën Terezës së Kalkutës që nxiti ndërtimin e spitalit. Një element që vlen të theksohet. Sistemi i kujdesit shëndetësor nuk është vetëm një mekanizëm burokratik për menaxhimin e botës komplekse të shëndetit dhe sëmundjeve por përmbushet plotësisht edhe përmes bashkëveprimit të një komuniteti shërues. Format e ndryshme të shërimit, trajtimit, kujdesit, ndihmës, qetësismit, kanë nevojë për një qasje simfonike nga operatorë të ndryshëm.

Siç ka thënë Papa Françesku: "Përmes dëshmisë së tyre shpirtërore dhe vëllazërore komuniteti i besimtarëve ndihmon dhe qetëson duke u kthyer kështu një komunitet shërues dhe duke konkretizuar në këtë mënyrë dëshirën e Jezusit që të gjithë të jenë një mish, një person, duke filluar nga më të dobëtit dhe më të pambrojturit. Roli i mjekëve, infermierëve, biologëve dhe teknikëve të laboratorit është gjithnjë e më i rëndësishëm, jo vetëm në aspektin profesional dhe shkencor por edhe në atë shpirtëror pasi janë thirrur të kujdesen për njerëzit në tërësinë e tyre trupore dhe shpirtërore." Kjo qasje është ekumenike, e hapur për të gjitha besimet dhe kontributin e të gjithëve.

Me këto mendime, në emër të komunitetit që drejton Fondacionin ju uroj të gjithëve **Gëzuar Krishtlindjet** dhe dashurinë maksimale të Zotit për njeriun, nëpërmjet Fëmijës që erdhi mes nesh, Jezusit.

# MIRËSEARDHJA e VEÇANTË për të RINJTË TANË

Çdo vit për UKZKM është një nisje nga e para sepse mikpret studentë të rinj, të cilët për herë të parë ulen në auditorët tona. Ndaj Rektori i Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" **Prof. Leonardo Palombi**, Zv. Rektori **Prof. Edmond Hajderi**, këshilltari i parë dhe kreu i zyrës konsullore të Ambasadës Italiane në Shqipëri **Z. Giacomo Montemarani**, Dekani i Fakultetit të Mjekësisë **Prof. Guido Macchiarelli** u dhanë mirëseardhjen studentëve italianë



re, duke e kthyer në avantazh të jashtëzakonshëm këtë mundësi që u është dhënë. Drejtuesit e UKZKM u kërkuan studentëve që të kenë besim dhe të mbështeten tek stafi akademik, pasi do të gjejnë gjithmonë ndihmën praktike dhe të dobishme për kryerjen me sukses të vitit të parë akademik.

që nisën vitin e parë akademik në UKZKM dhe studentëve shqiptarë që jetojnë në Itali, por zgjodhën universitetin tonë për të ardhmen e tyre profesionale. Takimi u mbaj në Aula Magna dhe kishte për qëllim të prezantonte tek studentët një vështrim të përgjithshëm të jetës që zhvillohet në Kampusin tone Universitar dhe Spitalor, i cili ndodhet shumë pranë qendrës së kryeqytetit shqiptar. Rektori i universitetit Prof. Leonardo Palombi i këshilloi studentët që të jetojnë plotësisht këtë eksperiencë të

Zv. Rektori Prof. Edmond Hajderi u dha studentëve këshilla praktike aq të nevojshme për vitin e parë akademik, ndërsa të rinjtë ambientohen në kampusin ndërkombëtar universitar. Përfaqësuesi i Ambasadës Italiane i ftoi studentët ta njohin thellësisht Shqipërinë gjatë kohës që do të kryejnë studimet këtu sepse tha ai Shqipëria është një vend mik i Italisë. Ndërsa Dekani i Mjekësisë i këshilloi studentët që të ndjekin me rigorozitet dhe maturi vitin e parë të studimeve, duke i ftuar të kenë besim tek strukturat akademike të UKZKM.



## Kopshti i të Drejtëve

# DREJT FAZËS SË DYTË

Më datë 6 mars u përurua Kopshti i të Drejtëve i promovuar nga Fondacioni ZKM. Gariwo, rrjeti ndërkombëtar i "Kopshteve" me qendër në Milano, ka përfshirë në website-in e tij një faqe të Kopshtit të Tiranës (<https://it.gariwo.net/giardini/giardino-di-tirana/>).

Tani po shkojmë drejt zgjedhjes së një ose më shumë të Drejtëve, emri i të cilëve do të gdhendet në gurët e mermertë të Kopshtit tonë. Në janar do të hapet një votim në të cilin do të mund të marrin pjesë të gjithë të pranishmit e strukturave operationale të Fondacionit. Për të mësuar rreth profilit të të drejtëve të propozuar për vitin 2025, mund të gjeni një broshurë në hyrjet kryesore të qendrave të ndryshme.



Një xhevahir i letërsisë malore

# MALI, çfarë PASIONI!


Shqipëria, një vend me det por mbi të gjitha me male. Ende për t'u zbuluar. Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të 11 Dhjetorit, në Universitetin ZKM do të prezantohet ribotimi anastatik i librit të Piero Ghiglione "Malet e Shqipërisë". Vepra e botuar në Tiranë në vitin 1941 në italisht dhe shqip, përfaqëson një xhevahir të letërsisë lidhur me malet dhe ka një vlerë të padyshimtë historike.



Kjo ditë e caktuar në vitin 2003 nga Asambleja e Kombeve të Bashkuara për këtë vit ka temën: "Zgjidhjet për zonat malore për një të ardhme të qëndrueshme: inovacion, përshtatje, të rinj dhe më gjerë". Ngjarja promovohet nga ZKM Press, struktura botuese e Universitetit e cila kishte shtypur tashmë disa kopje të saj në 2009. Të gjithë janë të ftuar.

Një histori e rizbuluar

## KUR LUIGJI MONTI U FUT NË BURG



Më datë 29 tetor doli në librari libri TË GJITHË NË ARREST - Historia e rizbuluar e Luigji Montit dhe shokëve të tij, botuar nga Ancora (fq. 260, € 19). Shkruar nga historiani Olmo Guagnetti, rrëfen ngjarje nga mesi i shekullit të nëntëmbëdhjetë që përfshinin Luigji Montin në rini dhe rreth dyzet shokë të tij. Historia është praktikisht e panjohur megjithëse trajton një episod ku protagoniste është një "Shoqëri" e akuzuar si shoqëri sekrete kundër qeverisë austro-hungareze që atëherë dominonte në Lombardi. Ajo që e bën më intrigues rrëfimin është denoncimi i të rinjve nga një prift, gjë që çoi në arrestimin dhe burgosjen e tyre në Desio. Këto janë faktet. Prej disa vitesh Luigji Monti ka mbledhur një grup bashkëmoshatarësh në zdrukthtarinë e shtëpisë së tij në Bovisio-Masciago (Provincë e Monza Brianza), me mbështetjen e famullitarit dhe mikut të tij Don Dossi.

Nisma zhvillohet gjatë një dekade, por hasi në kundërshtimin e disa priftërinjve famullitarë të zonës, të cilët e bindën famullitarin e ri të raportonte këtë Shoqëri në polici, të cilën njerëzit e quanin me kënaqësi "fretërit", për shkak të frymës së vëllazërisë që gjallëronte grupin. Janë vite të vështira, të cilat kulmuan në vitin 1848 me "Pesë Ditët" e famshme të Milanos. Arrestimi daton në vitin 1851, në prag të mbërritjes së perandorit Francesco Giuseppe nga Vjena. Klima është e tensionuar politikisht dhe disa nga klerikët nuk ishin në favor të veprimtarisë fetare të këtyre të rinjve që udhëhiqeshin nga një djalosh laik.

Për këtë çështje interesohet edhe kryepeshkopi i Milanos, Imzot. Romilli, i cili ndërmjetëson në emër të djemve të Perandorit që ka mbërritur në qytet, por pa asnjë rezultat: Francesco Giuseppe beson se drejtësia duhet të ndjekë rrugën e saj. Pas dy muajsh e gjysmë, 17 të arrestuarit u shpallën të pafajshëm dhe u lanë të lirë. Ngjarjet e Bovisio-s janë lajme të një epoke të shkuar, megjithatë ato përfaqësojnë një rrëfim të protagonizmit të të rinjve në kishë që vlen edhe për kohën tonë, ku shohim një largim të një pjese të madhe të rinisë nga jeta e krishterë. Luigji dhe shokë të tjerë si ai, sapo u liruan nga burgu, filluan një rrugë të shenjtërimin laik që do të sillte në themelimin e një komuniteti fetar kushtuar të sëmureve dhe fëmijëve më të rrezikuar. Sot ai komunitet është i pranishëm në Shqipëri me Fondacionin ZKM.

Prezantimi hyrës është nga Ruggero Valentini, i cili vitet e fundit është përkushtuar për të bërë të njohur këtë fragment historie, të risjell me një qasje shpirtërore dhe edukative në librin *Fratello è bello*. (Ancora, 2024, fq. 96, € 9). Luigji Monti u shpall "i lum" nga Papa Wojtyła në vitin 2003.

# SISTEMET E KUJDESIT SHËNDETËSOR NDAJ MOSHËS SË TRETË NË DITËT E SOTME

Në Aula "Magna" në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" u zhvillua konferenca shkencore me temë "Gjendja e të moshuarve në Ballkan dhe Evropën Lindore: Sfidat dhe Mundësitë".

Konferenca u organizua nën kujdesin e Rektorit të Universitetit Katolik **Prof. Leonardo Palombi** dhe Akademisë Romake të Shëndetit Publik pranë UKZKM. Takimi ndërkombëtar mikpritur autoritete lokale dhe qendrore të Republikës së Shqipërisë dhe të agjensive shtetërore italiane, deputetë të Parlamentit të Shqipërisë, Rektorin e Universitetit partner "Tor Vergata" të Romës, ekspertë të

edhe për ata që kanë vështirësi fizike. Duke krijuar një rrjet të qëndrueshëm të universiteteve, mund të bashkohen edhe projektet kërkimore bashkë me Akademinë Romake të Shëndetit Publik. Në konferencë u përshëndetën posaçërisht të ftuarit që erdhën nga shumë vende



Ballkanike dhe të Evropës Lindore, duke e kthyer këtë takim në Tiranë si një motor të përbashkët kërkimi dhe zhvillimi. Në emër të Ambasadorit Italian përshëndeti Drejtoresha e Agjensisë Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Zj. Stefania Vizzaccaro, e cila vlerësoi mundësitë që ofron kjo konferencë ndërkombëtar për të krijuar hapësira komunikimi e bashkëpunimi për moshën e tretë.



njohur vendas e të huaj në fushën e mjekësisë, kërkimeve shkencore, sociale, të të dhënave demografike, studentë etj. Konferencën e përshëndeti në hapje Presidenti i Fondacionit Zoja e Këshillit të Mirë **fr. Ruggero Valentini**, i cili tha se ky takim ndërkombëtar që zhvillohet në UKZKM është kontribut për të mbështetur konkretisht moshën e



Në konferencë folën Zv. ministrja e Shëndetësisë **Denada Seferi**, **Dr. Eugena Tomini**, Nënkryetari i Bashkisë së Tiranës **Andi Seferi**, të cilët treguan se autoritetet shqiptare po rrisin



tretë. Fr. Ruggero Valentini tha se për shkak të zhvillimit të shoqërive tona sot prindërit e moshuar ndihen të braktisur dhe kjo mbetet një sfidë për t'u kapërcyer.

**Monsinjur Vincenzo Paglia** tha se ishte i lumtur që ëndrra e tij po bëhej realitet. "Kur u vu guri i themelit të këtij universiteti, tha Monsinjur Paglia, dëshiroja që ky institucion të bëhej një pikë bashkimi për Evropën Lindore dhe Ballkanin. Sot kjo ëndërr po bëhet realitet dhe e vetmja perspektive që duhet të shohim është Evropa e bashkuar. Rektori i Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" tregoi në prezantimet e tij shkencore studime të hollësishme me të dhëna që tregojnë se duhet të lehtësohen shërbimet shëndetësore në sektorin e shëndetit publik për të moshuarit, sidomos



vigjilencën ndaj nevojave të moshës së tretë duke krijuar mekanizma mbrojtjeje për ta. Konferenca analizoi në panele të ndryshme kushtet aktuale dhe nevojën për ndryshime në sistemet e kujdesit shëndetësor të Shqipërisë, Ballkanit dhe të gjithë Evropës Lindore. Gjithashtu u prezantua Karta për të drejtat e të moshuarve dhe e detyrave të komunitetit për mbrojtjen e tyre nga paragjykimet dhe përjashtimet.



Një vështrim  
për të  
Ardhmen

# DREJT NJË RRJETI TË RI AKADEMIK PËR PLAKJEN AKTIVE NË BALLKAN DHE EVROPËN LINDORE

Vepimetaria u fokusua në një çështje thelbësore për politikën shëndetësore dhe sociale të kohës sonë: si të përballemi me plakjen e popullsisë në një kontekst gjithnjë e më kompleks dhe me burime të kufizuara. Tranzicioni demografik, një fenomen që ka parë rritje të konsiderueshme si të popullsisë ashtu edhe të jetëgjatësisë, e ka kthyer plakjen në një nga sfidat kryesore për qeveritë. Kjo vlen veçanërisht për Ballkanin dhe Evropën Lindore, ku kombinimi i migrimit, rënies demografike dhe varfërisë përkeqëson vështirësitë e të moshuarve.

## Përgjigja? Një rrjet akademik për të krijuar një qasje të integruar dhe të qëndrueshme.

Projekti i cili e sheh RAPH si lider synon të krijoj një lëvizje që nuk e konsideron plakjen si kosto, por si një burim strategjik dhe esencjal. Ndër objektivat kryesore janë promovimi i përfshirjes sociale, valorizimi i të moshuarve dhe zhvillimi i modeleve të kujdesit shëndetësor me në qendër komunitetin dhe jo spitalet.

## Perspektiva e Vendeve të Përfshira

Duhet përmendur disa pika kryesore pasi përfaqësues nga shtatë vende të pranishme ofruan përvoja dhe strategji të ndryshme. Në Shqipëri theksi duhet të

të moshuarve. Njëkohësisht reformat e pensioneve synojnë të sigurojnë një sistem të qëndrueshëm dhe adekuat. Ndërsa në **Kosovë** shërbimet publike për të moshuarit kanë mangësi strukturore. Zgjidhjet inovative, si përdorimi i teknologjisë dhe një integrim më i madh midis kujdesit shëndetësor dhe atij social janë thelbësore për të përmirësuar cilësinë e jetës. Së fundi, në **Slovaki** paraqesin prioritet parandalimi dhe menaxhimi i sëmundjeve kardiovaskulare të cilat janë shkaqet kryesore të shtrimit në spital të të moshuarve. Nevojiten gjithashtu ndërhyrje të mëtejshme për të vlerësuar në mënyrë gjithëpërfshirëse nevojat e të moshuarve dhe për të mbushur boshllëqet në shërbimet ekzistuese.



## Një Vështrim drejt së Ardhmes

Kjo konferencë nuk ishte thjesht një moment reflektimi, por një hap konkret drejt një nisme të përbashkët për të shkëmbyer përvoja dhe kërkime me synimin për ta shndërruar plakjen në një burim të progresit social. Ideja e një **Karte të të Drejtave të Personave të Moshuar dhe Detyrave të Komunitetit** paraqet thelbin e këtij vizioni, duke qenë në këtë mënyrë një dokument që promovon dinjitetin, pjesëmarrjen aktive dhe respektin e ndërsjellë midis brezave. Puna e përbashkët, shkëmbimi i praktikave më të mira dhe gjetja e zgjidhjeve inovative janë çelësi për adresimin e kësaj sfide globale. Siç tregohet edhe nga kontributet e vendeve të ndryshme ka ende shumë për të bërë, por rruga drejt plakjes aktive dhe dinjitoze tashmë është e qartë.

vendoset tek avantazhi i forcimit të rrjeteve mbështetëse të komunitetit për të ndaluar izolimin e të moshuarve. Megjithatë, për të siguruar një efikasitet më të madh nevojiten politika kombëtare që sigurojnë përfshirjen e kujdesit geriatrik në shërbimet shëndetësore dhe sociale. Aktualisht në **Armeni**, çështja kryesore është adresimi i sfidës demografike. Asistenca e fokusuar në mbajtjen dhe kthimin e të rinjve së bashku me masat e stabilitetit kulturor dhe etnik mund të jenë të dobishme për uljen e ndikimit të plakjes. Në **Rumani**, projektet pilot të kujdesit të integruar të cilat kombinojnë shërbimet shëndetësore dhe sociale kanë treguar sukses. Prandaj synohet që kjo qasje të zgjerohet në nivel kombëtar dhe të sigurohet një mbështetje më e madhe për kujdestarët e familjes të cilët shpesh lihen të vetëm për të trajtuar problemet e të moshuarve. Në **Serbi** fragmentimi i shërbimeve paraqet një pengesë. Një qasje e koordinuar mund të përmirësojë aksesin në kujdesin shëndetësor dhe të zvogëlojë ngarkesën e kujdestarëve informalë, të cilët kanë nevojë për më shumë trajnim dhe mbështetje. **Maqedonia e Veriut** fokusohet në programet e plakjes aktive që promovojnë shëndetin fizik dhe mendor të



**Më shumë informacion:** <https://www.unizkm.al/events/31-ottobre-2024-conferenza-la-condizione-degli-anziani-nei-balcani-e-nelleuropa-dellest-sfide-e-opportunita/en>

## BALLKANI PERËNDIMOR ME SYTË NGA BE

Qendra Evropiane për Shkencën e Paqes, Integrimin dhe Bashkëpunimin pranë Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" organizoi takimin me temë "Zgjerimi: Çështje dhe Perspektiva në Ballkanin Perëndimor".

Qëllim i këtij takimi ishte thellimi i vështrimit mbi procesin e zgjerimit të Bashkimit Evropian drejt vendeve të Ballkanit

jetë pjesë e BE-së, duke sjellë në vëmendje të audiencës edhe shprehjen e rilindasit Pashko Vasa që thoshte se "Feja e Shqiptarit është shqiptaria", duke e treguar këtë si konfirmim të harmonisë me të cilën shqiptarët jetojnë me vlerat evropiane. Drejtori i CESPIC **Prof. Raul Caruso** duke prezantuar një pamje të gjerë të kushteve në të cilat po



Perëndimor. Në ditët e sotme ekzistojnë shumë mundësi që të eksplorojnë perspektivat e ndryshme të këtij procesi përmes një qasjeje ndërdisiplinore dhe kjo u bë e mundur në këtë takim, nëpërmjet këndvështrimeve të folësve të ftuar. Takimi u organizua në bashkëpunim me Observatorin Ballkanik dhe të Kaukazit Transeuropian. Në mirëseardhjen drejtuar të ftuarve Presidenti i Fondacionit Zoja e Këshillit të Mirë **fr. Ruggero Valentini** citoi thënien e Ish-kryeministrit Italian Romano Prodi, i cili në një nga vizitat e tij në Shqipëri tha se bota është e rrethuar nga konfliktet, por në Evropë kemi një zgjidhje, Bashkimin Evropian. Në këtë përmbajtje fr. Ruggero Valentini tha se Shqipëria është një vend me tipare të forta evropiane sepse vetë Evropa është një bashkësi ku kapërcehen konfliktet. Ai tha se Shqipëria e meriton të

ndodh procesi i zgjerimit tha se Evropa është frymëzim dhe duhet të njohim perspektivat e procesit.

Në konferencë ishte i pranishëm **Dr. Albert Rakipi**, Drejtor i Institutit për Studime Ndërkombëtare, i cili tha se pyetja kryesore mbetet sesi vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të ndërtojnë shtetin ligjor dhe demokratik.

Zonja **Marta Szpalla** solli eksperiencën e Polonisë në kohën kur ky vend u anëtarësua në Bashkimin Evropian, si një shembull që tregon edhe për zgjerimin e mëtejshëm të unionit. Ndërsa zonja **Luiza Chiodi** drejtuese e Observatorit Ballkanik dhe të Kaukazit Transeuropian u ndal tek çështjet që marrin vëmendje sot në BE si tregu i lirë ekonomik, energjia, siguria dhe migracioni.

Drejt cilës politikë energjetike?

## PASOJAT PËR VENDET E RAJONIT TË BALLKANIT

Zgjerimi i Bashkimit Evropian përcakton një shtrirje progresive të zbatimit të ligjit dhe politikave të Unionit në Shtetet e reja anëtare. Megjithatë ky zbatim nuk është i menjëhershëm dhe aq më pak i plotë. Dallimet ekonomike, sociale dhe ligjore midis shteteve të reja anëtare dhe atyre ekzistuese çojnë në planifikimin e anëtarësimit dhe përfshirjen e "klauzolave mbrojtëse" në aktet përkatëse për të marrë parasysh barrën dhe vështirësitë që hasin këto shtete të reja anëtare në përshtatjen me standardet rregullatorë evropiane ekzistuese. E gjitha kjo është veçanërisht e rëndësishme në lidhje me politikën energjetike të BE-së. Objektivi i konferencës së organizuar nga UKZKM është pikërisht të kuptojë nëse kjo politikë ka një ndikim tek shtetet kandidatë për anëtarësim dhe sa është niveli i ndikimit, duke iu referuar specifikisht atyre të rajonit të Ballkanit. Eventi i energjisë në fund të nëntorit 2024 mbajtur në UKZKM u morr me Benefit Corporations dhe Environmental, Social, Governance. Kompanitë janë gjithnjë e më shumë të përkushtuara për të harmonizuar qëllimet e fitimit me ato të etikës, qëndrueshmërisë ekologjike dhe mirëqenies së përgjithshme.

Vendimmarrësit politikë si në nivel të brendshëm ashtu edhe në nivel ndërkombëtar janë sot veçanërisht të kujdesshëm në drejtimin e operatorëve të tregut drejt disa standardeve të prodhimit, për të garantuar një ndikim pozitiv për punonjësit dhe familjet e tyre, për mjedisin natyror dhe, më gjerësisht për shoqërinë në tërësi, duke përfshirë brezat e ardhshëm. Nga këtu mund të kuptojmë rëndësinë e trajtimit të çështjes komplekse si nga pikëpamja teorike, duke sqaruar sa më mirë parimet e reja juridiko-ekonomike që e frymëzojnë atë, ashtu dhe nga pikëpamja praktike, duke raportuar shembuj konkretë të zbatimit të këtyre parimeve, veçanërisht në lidhje me sektorin financiar.

## SUKSES DHE MERITË PËR STUDENTËT TANË

“Sakrificat e rinisë janë jorgan i pleqërisë” thotë një shprehje e urtë shqiptare. Kësaj disipline të pashkruar në libra, por të jetuar ndër shekuj i përgjigjen studentët tanë, të cilët me sakrificat, por me meritë u diplomuan në programet tona të studimit gjatë këtij sezoni universitar, duke mbyllur me sukses studimet e tyre universitare.



Shtatë studentë dëshmitarë të besimit

## NJË DITË E PAHARRUESHME

Ndodh rrallë që salla Aula Magna e universitetit të bëhet gjithashtu vendi i një riti të veçantë fetar, gjë e cila ndodhi më 5 nëntor. Me rastin e Festës së Martirëve të Shqipërisë, shtatë studentë morën nga ipeshkvi i Tiranës, z. Arian Dodaj Sakramentin e Konfirmimit. Bëhet fjalë për një ngjarje të veçantë në rrugëtimin shpirtëror të një të krishteri, me të cilin ai konfirmon aderimin e tij ndaj Krishtit dhe merr përsipër me gëzim përgjegjësinë për të dëshmuar për të gjatë jetës.



Vullneti i mirë i besimtarit konfirmohet nga Fryma e Zotit që thirret mbi të. Emocioni i të pranishmëve ishte i madh duke parë gjestin e guximshëm të disa studentëve të rinj.

Dhurim për kampusin tonë universitar

## DHURO GJAK, SHPËTO JETË!

Gjatë çdo viti kalendarik kampusi ynë universitar hap dyert për Organizatën Shqiptare të Dhuruesve Vullnetarë të Gjaku, duke u dhënë mundësi të gjithëve të kontribuojnë për ata që kanë më shumë nevojë për gjak. Nën kujdesin e bluzave të bardha të Spitalit Katolik të gjithë ndoqën protokollin e përcaktuar për këtë rast.



# PELEGRINËT drejt SARONOS dhe ROMËS

Dyqindvjetori  
i Luigji Montit

Në vitin 2025 festohet Jubileu (ose Viti i Shenjtë) i cili zakonisht ndodh çdo 25 vjet. Përkon në këtë mënyrë me dyqindvjetorin e lindjes së themeluesit Atë Monti (1825). Kjo rrethanë e lumtur sugjeron organizimin e një udhëtimi në Itali për të marrë pjesë në ngjarje të tilla shpirtërore. Një pelegrinazh i të rinjve në Saronno në gjurmët e At Montit është planifikuar për dhjetë ditët e fundit të korrikut, për të përfunduar më pas në Romë për aktivitetet jubilarë. Të rinjtë e interesuar mund të shprehin dëshirën për të marrë pjesë duke dërguar një kërkesë tek Atë Paschal, animator shpirtëror i Universitetit.

**BICENTENARIO  
MONTIANO**  
1825-2025 NASCITA  
BEATO LUIGI MARIA MONTI  
Un anno giubilare da vivere assieme



Të rriturit mund të kontaktojnë sekretariatit e Presidencës (k.dema@fzkm.org) për të mbledhur anëtarësimet e mundshme për një pelegrinazh që do të organizohet gjatë gjithë verës..

## ARMIDA BARELLI, NJË GRUA E FORTË

Bashkëthemeluesja  
e Universitetit Katolik  
të Milanos

Armida Barelli (1882-1952) është një figurë kryesore për guximin e besimit, prirjen e theksuar për të vepruar dhe modernitetin e personalitetit të saj. Papa Françesku e shpalli atë "të lum" në vitin 2022 dhe së fundmi Universiteti Katolik i Milanos (titulli më i lartë) i dhuroi Universitetit tonë një relike të Armidës, që ruhet në kapelën e Spitalit ZKM.

Me rastin e kujtimit liturgjik të të Lumes, të martën më 19 nëntor u kremtua mesha e shenjtë.



Studentët tanë lëvrojnë  
shkrimin e publicistikën

## TAKIM ME LETERSINË



Pavarësisht profilit thellësisht shkencor të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" në Kampusin Universitar i jepet hapësirë artit të të shkruarit, duke nxitur leximin dhe krijimin e modeleve që ushqejnë mendjen dhe shpirtin me të bukurën. Sot në UKZKM u zhvillua "Takimi me Letërsinë", jo vetëm se jemi në muajin e leximit, por edhe sepse mbështesim studentët tanë që të krijojnë një botë të pasur kulturore. Në takim të organizuar nën kujdesin e drejtueses së Bibliotekës së UKZKM, Mimoza Agastra, me këshillat e vyera të profesoreshës tonë të Kulturës Italiane Edlira Bejko, studentët shqiptarë dhe italianë lexuan poezi dhe proza të kolosëve të letërsisë shqiptare si Migjeni, Ismail Kadare, Dritëro Agolli dhe Gjergj Fishta.

Disa prej poezive të shkrimtarëve tanë të mëdhenj u lexuan nga studentët italianë, të përshtatura në gjuhën shqipe nga Prof. Edlira Bejko. Të rinjtë morën duartrokitje në sallë edhe për krijimet e tyre individuale që janë redaktuar nga shkrimtarja Mimoza Agastra. Ky takim krijoi një atmosferë emocionuese duke përfshirë të ftuarit në një bisedë aktive. Mes studentëve tanë ka edhe fitues të çmimeve letrare në konkurset kombëtare dhe lokale të letërsisë, duke na bërë krenarë për iniciativat e tilla që bashkojnë të rinjtë, pedagogët dhe stafin mbështetës të UKZKM rreth librit, dijes dhe leximit. Të promovojmë dijen dhe aftësitë e saj që përshkojnë identitetin tonë, tha Prof. Edlira Bejko, e cila i inkurajoi studentët të lexojnë sepse kështu përqafojnë vlera të pasura njerëzore. Gjithashtu studentëve të Arkitekturës iu dhuruan disa botime nga Biblioteka e UKZKM me synim rritjen e dimensioneve të tyre profesionale.



## UKZKM DHE SPITALI KATOLIK NDËRGJEGJËSOJNË PËR JETËN


Organizata Botërore e Shëndetësisë ka përcaktuar Tetorin si muajin e kujdesit për të parandaluar kancerin e gjirit. Stenda e UKZKM në Sheshin Skënderbeu u bë streha e studentëve dhe miqve që dëgjuan një histori domethënëse për jetën dhe kurajon për të luftuar për të, nga shembulli i Zj. Hajrie Braçellari, e cila e përballoi me sukses betejën kundër kancerit të gjirit. Në stendën tonë vajzat dhe gratë ndoqën edhe një demonstrim praktik të mjekes së Spitalit Katolik doktoreshë Manjola Luzi, e cila tregoi sesi mund të kujdesemi për veten duke nisur nga kontrollet e trupit tonë.

Tetori Rozë është muaji i kujtesës dhe nderimit me perulësi për ato vajza e gra që kanë luftuar me këtë sëmundje, luftojnë për të jetuar jetën! Kontrolli i herë pas hershëm shpëton jetën ndaj UKZKM i bashkohet kësaj iniciative ndërgjegjësuese çdo vit, për të mbrojtur jetën.



Maratona  
di Tirana

## FIZIOTERAPISTËT TANË, NDIHMË DHE KUJDES NDAJ VRAPUESVE



Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" është pjesë e maratonës së Tiranës. Vrapuesit tanë u bënë pjesë e kësaj ngjarjeje që bashkoi mijëra njerëz në kryeqytet. Në stendën tonë me dhjetra garues morën ndihmën e nevojshme para dhe pas maratonës nga fizioterapistët tanë të udhëhequr nga përgjegjësi i praktikave klinike ne UKZKM Ph.D. Florian Spada.

Stenda jonë është si përherë ndalesa e dëshiruar për të apasionarit e vrapimit të gjatë që pas kilometrave të përshkuara nën ethet e garës, kanë nevojë për kujdes të shtuar. Në Tiranën tonë jemi krenarë për mbështetjen që UKZKM jep gjithmonë, duke qenë motivues i shëndetit dhe edukimit. Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" u prezantua në Sheshin Skënderbeu me stendën e tij gjatë ditëve të maratonës duke u bërë pjesë e organizimit të Bashkisë së Tiranës edhe me vrapimin e nxënësve të shkollave të mesme.



Në stendën tonë fizioterapistët dhanë këshilla dhe asistencë për maturantët sesi të kujdesen gjatë aktiviteteve fizike. Në stendë u dhanë këshilla edhe për një ushqyerje të shëndetshme si pjesë e ndërtimit të një rutine të dobishme për shëndetin. Spitali Katolik dhe UKZKM janë të përkushtuar për jetën dhe edukimin duke dhënë ndihmën e tyre profesionale.

# TRENTINO THËRRET...

Komuniteti  
nga Atë Monti  
në "Tokën  
e shqiponjave"

Ndiqni intervistën e dhënë nga fr. Ruggero Valentini për programin e krijuar nga Dioqeza e Trentos.

[https://www.youtube.com/watch?v=0yYlwnIH\\_wY](https://www.youtube.com/watch?v=0yYlwnIH_wY)



Takimi në Turqi

## UKZKM PJESË E RRJETIT UNIVERSITAR PRESTIGJOZ TË MESDHEUT

Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" u përfaqësua në Asamblenë e Përgjithshme të Universiteteve Mesdhetare që u mbajt në Stamboll nga delegatja e Rektorit të UKZKM **Prof. Angela Andreoli**. Takimi u mbajt në Universitetin "Aydin" të Stambollit nën kujdesin e Parlamentit Evropian dhe Unionit për Mesdheun. Në asamble morën pjesë mbi 200 pjesëmarrës që nga anëtarët e UNIMED deri tek partnerët institucionalë.

Gjatë këtij takimi vjetor rektorët, presidentët dhe përfaqësuesit e UNIMED ndanë ide dhe orientime për të përcaktuar politikën e ardhshme të UNIMED, duke hedhur bazat për një vit të ri plot iniciativë, aktivitete dhe konferenca që kontribuojnë në panoramën akademike të Mesdheut dhe të Ballkanit.

Këtë vit punimet e Asamblesë u fokusuan në rolin e universiteteve në kontekstin e një situatë krize në rritje. Rajoni i Mesdheut ka nevojë për bashkëpunim të gjerë mes universiteteve pasi e drejta për arsimim e shumë studentëve shpesh vihet në rrezik dhe liria akademike është prioritarë për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm.



Gjatë Asamblesë fushat prioritare të diskutimit përfshinë qeverisjen universitare, arsimin dixhital, dialogun ndërkulturor, zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbështetjen për refugjatët dhe emigrantët. Relatorët e profilit të lartë pasuruan debatet mbi sfidat e arsimit të lartë, arsimin në gjendjet e emergjencave, bashkëpunimin me universitetet afrikane dhe ballkanike, programet evropiane dhe qeverisjen ndërkombëtare. Viti 2025 shënon 30 vjetorin e Procesit të Barcelonës, një mundësi e mirë reflektimi për hapat e ardhshëm të një bashkëpunimi që i sheh universitetet si protagonistë në ndërtimin e një rajoni mesdhetar më gjithëpërfshirës dhe më të hapur. Mes propozimeve lind ideja e një takimi me Ministrat e Arsimit të vendeve të Mesdheut dhe të gjithë Evropës, duke pasur si synim forcimin dhe zgjerimin e programit Erasmus Plus dhe duke vendosur studentët në qendër të politikave universitare.

## LEKSIONI I HAPUR PËR KIRURGJINË MAKSILOFACIALE NË UKZKM

Në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" është praktikë e konsoliduar prezantimi i specializimeve afatgjata në fusha të ndryshme që lidhen me programet tona të studimit. E tillë ishte edhe ora e hapur në fushën e Mjekësisë në Kirurgjinë Maksilofaciale.

Kirurgjia Maksilofaciale për herë të parë do të mësohet dhe aplikohet sipas modeleve europiane në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" nën drejtimin e prof. Sandro Pelo, kirurg maksilofacial dhe koordinatori i specializimit afatgjatë të fushës Mjekësore në Kirurgjinë Maksilofaciale. Ky profil i kirurgjisë kryen rindërtimin e defekteve kongjenitale, sindromave zhvillimore ose kongjenitale ose të fituara më pas për shkak të sëmundjeve tumorale, si dhe dëmtimeve të shkaktuara nga trauma të rënda.

Kirurgjia Maksilofaciale kërkon edhe një zotërim të mirë dhe të plotë të teknikave mikrovaskulare, të cilat aplikohen me sukses në ndërhyrjet e fundit kirurgjikale në Spitalin Katolik. Një sektor i rëndësishëm i këtij specialiteti është edhe kirurgjia plastike, e cila merret me trajtimin e plakjes së lëkurës së fytyrës dhe teknikat rigjeneruese të disa zonave të saj.

**Leksion i hapur**  
**Program Specializues Afatgjatë në Kirurgji Maksilofaciale**

**Relatorë**  
**Prof. Sandro Pelo**  
Kirurg Maksilofacial,  
Spitali Katolik  
Zoja e Këshillit të Mirë  
**Dr. Ermal Pashaj**  
Kirurg Maksilofacial,  
Spitali Katolik  
Zoja e Këshillit të Mirë

**18 Nëntor 2024**  
**16:30**  
**Aula B105**  
Universiteti Katolik  
"Zoja e Këshillit të Mirë"

www.unizkm.al

Mësimi i hapur u mbajt nga prof. Sandro Pelo, kirurg dhe mjek maksilofacial dhe Dr. Ermal Pashaj, kirurg maksilofacial në Spitalin Katolik Zoja e Këshillit të Mirë"

### Edukimi i të vegjëlve

## PËR NJË BUZËQESHJË TË BUKUR DUHET GJITHMONË KUJDES!

Klinika e Stomatologjisë pranë Spitalit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" organizoi një takim edukativ dhe argëtues me prindër e fëmijë, i cili synoi të rrisë kujdesin e të vegjëlve ndaj higjienës orale. Takimi me titull "Aventurat e Buzëqeshjes së Shëndetshme" shërbeu si një eksperiencë



praktike edhe për prindërit që monitorojnë rritjen e fëmijëve të tyre edhe në këtë aspekt. Mjekët, dentistët e Korpusit tonë Spitalor dhe Stomatologjik folën për rëndësinë e higjienës dentare në një mënyrë interactive tek vogëlushët dhe fëmijët deri në 10 vjeç. Takimi u zhvillua mes lojërave,

argëttimeve dhe shpërndarjes së dhuratave për të vegjlit, duke i inkurajuar ata të zhvillojnë disiplina ditore të shëndetshme për kujdesin dentar. Ne jemi të përkushtuar ndaj shëndetit dhe jo vetëm krijojmë kujtime të bukura në këto aktivitete, por edhe i ndihmojmë fëmijët të kuptojnë rëndësinë e një shëndeti të mirë që nis nga goja dhe dhëmbët e pastër dhe të shëndetshëm.



# GJITHË BOTA NË NJË PROGRAM

Në kuadër të programit Erasmus+ (mobilitet për mësimdhënie) gjatë javës 7-11 tetor 2024, Prof. Asoc. Malvina Hoxha dhe PhD. Arvjola Hodaj, nga Departamenti për Vlerësimin Kimiko-Toksikologjik dhe Farmakologjik të Barnave vizituan Fakultetin e Farmacisë në Universitetin e Urbinos "Carlo Bo".

Prof. Piero Sestili dhe Prof. Andrea Guidarelli mirëpritën Prof. Assoc. Malvina Hoxha në katedrën e Farmakologjisë. Prof. Hoxha zhvilloi leksione farmakologjie për studentët e vitit të tretë të Farmacisë dhe studentët e Kimisë dhe Teknologjisë Farmaceutike (CTF), ku diskutoi mbi terapinë farmakologjike të paralizës cerebrale infantile dhe sklerozës multiple, si dhe mbajti leksion për kolegët e Farmakologjisë të Universitetit të Urbinos në lidhje me rolin e eikozanoideve në infeksionet virale.



PhD. Arvjola Hodaj zhvilloi leksione dhe praktika laboratorike në laboratorin e "Quantitative drugs analyses and laboratory", Fakulteti i Farmacisë. Falë ndihmës të Prof. Andrea Duranti dhe Prof. Asoc. Simone Lucarini, u bë e mundur vizita në ambjentet e laboreve të kërkimit shkencor, si dhe vendosja e kontakteve të reja për bashkëpunime të mëtejshme.



## FARMACI dhe ARKITEKTURË

Universitetit ynë mori pjesë në dy Programe Intensive të Përziera #Erasmus+ (BIP) "BOOST - Biodiversiteti për Shëndet të Qëndrueshëm" dhe "EX MIND -Extended Mind for Design of Human Environment" organizuar nga Departamenti i Farmacisë dhe Arkitekturës të Universitetit të Chieti- Pescara "D'Annunzio" në bashkëpunim me universitete të tjera të BE-së. Të dy programet ofruan një përvojë pasuruese të të mësuarit akademik dhe aktiviteteve kulturore, të cilat kombinuan seancat virtuale dhe ato individuale.

Profesoresha e asociuar Silvi Bozo së bashku me studentët e farmacisë Klea Bendo, Xhijola Duro, Kamila Domi, Artejana Marku dhe Ermela Sulaj morën pjesë aktive në këtë program bashkëpunimi, ndryshe të quajtur BOOST. Profesoresha Bozo prezantoi universitetin tonë dhe pikat e forta në programin e studimit në farmaci.



Ky takim siguroi një platformë unike për studentët për të eksploruar kryqëzimin e biodiversitetit dhe shëndetit, duke thelluar të kuptuarit e tyre për biodiversitetin në shëndetin e qëndrueshëm dhe praktikat e qëndrueshme në farmaci.

Ndërsa studentët e Arkitekturës Klaudia Guzhda dhe Eni Maliqati morën pjesë aktive dhe u angazhuan në leksione, punëtori, projekte bashkëpunuese dhe vizita në terren në projektin EX MIND duke eksploruar koncepte inovatore të projektimit për të kontribuar në diskutime mbi hapësirat e gjelbërta dhe publike, në dimensionet e objekteve dhe më shumë. Përveç rritjes së aftësive dhe njohurive të studentëve dhe stafit këto programe lehtësuan rrjetëzimin me studentë ndërkombëtarë, me stafe të reja dhe ekspertë të fushës.



Erasmus+

## RRJETËZIMI ME PROGRAMET NDËRKOMBËTARE



Në kuadër të programit Erasmus+ lëvizshmëri për trajnimin e stafit nga data 7 deri më 11 tetor 2024 drejtuesja e Sekretariatit Mësimor të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" Dr. Diljana Dushku vizitoi Universitetin partnpartn të Romës "Tor Vergata". Qëndrimi i saj në universitetin partner u mirëprit në zyra të ndryshme të ngjashme ku u shkëmbyen përvoja në kuadrin e proceseve të përbashkëta dhe u vendosën kontakte të reja për bashkëpunime të mëtejshme, me synim përmirësimin dhe ofrimin e shërbimeve standarde të cilësisë së lartë për studentët dhe stafin pedagogjik. UKZKM rrit në këtë mënyrë aftësitë për shërbime moderne sin ë vendet anëtare të BE-së.



*Krishtlindje*  
**2024**

**Urimet më të mira për të gjithë Komunitetin Spitalor dhe Universitetin:**  
*që kjo festë të shtojë dëshirën tonë ndaj të mirës dhe paqes!*





## GIORNATA INTERNAZIONALE CONTRO LA VIOLENZA SULLE DONNE

INCONTRO



*"La vita non è una questione di come sopravvivere alla tempesta, ma di come danzare nella pioggia..."*

(Lettera di Gino Cecchetti)

📅 25 novembre 2024  
🕒 ore 14:30  
📍 Campus dell'Università Cattolica  
"Nostra Signora del Buon Consiglio"



### Convegno

## LA POLITICA ENERGETICA DELL'UE NELLA PROSPETTIVA DI ALLARGAMENTO ALL'AREA BALCANICA

26  
Novembre  
2024

15:00

Aula 11-12 Casa Rossa  
Università Cattolica  
Nostra Signora del Buon Consiglio

27  
Novembre  
2024

10:00

Aula 11-12 Casa Rossa  
Università Cattolica  
Nostra Signora del Buon Consiglio



TRENTO  
Capitale Europea  
del Volontariato

## GIORNATA MONDIALE INTERNAZIONALE DEL VOLONTARIATO

5 dicembre 2024  
ore 17:00  
Aula Magna



UNIVERSITÀ CATTOLICA  
NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO

### Conferenza

## B Corp e sostenibilità in azienda. Novità e applicazioni del paradigma ESG.

5 dicembre 2024 / ore 10.30



## Seduta di Laurea Farmacia

6 Dicembre 2024  
Aula Magna



Spitali Katolik  
Zoja e Këshillit të Mirë  
Përkushtuar Shëndetit Tënd

Prof.  
**Fabian  
Cenko**

### Seminario

## Il ruolo della Medicina di Laboratorio nella gestione delle patologie oncologiche

7 dicembre 2024




## GIORNATA INTERNAZIONALE DELLA MONTAGNA

## Presentazione Libro di PIERO GHIGLIONE

11 dicembre 2024

15:30

Aula Magna  
UNBC



## INCONTRO LETTERARIO BIBLIOTECA - STUDENTI